



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-23659

Dt: 29.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në nenin 17. 1. të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr 06-20027-7/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt:15.04.2016, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për pjesëmarrje në “Panairin e Turizmit 2016” në Prishtinë, me dt: 29.04.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për pjesëmarrje në “Panairin e Turizmit 2016”, i cili do të organizohet nga CEO (Congress and Event Organization) në Prishtinë duke e mbështetur këtë kërkesë me mjete financiare të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në vlerë prej 1,351.10€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,351.10€, nga mjetet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik nga linja për mallra dhe shërbime në xhirollogarinë e N.P.Sh. “CEO” sh.p.k nr. 1110228169000183 Procredit Bank, me të cilat do të mundësohet realizimi i kërkesës të përshkruar në pikën paraprake.

A R S Y E T I M

Znj. Silvana Domi, drejtoresh në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt. 15.04.2016 ka parashtruar kërkesë për pjesëmarrjen e disa bizneseve të sektorëve të ndryshme të Komunës së Gjakovës në “Panairin e Turizmit 2016”, i cili do të organizohet nga CEO (Congress and Event Organization) në Prishtinë.

Pas diskutimeve lidhure me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Kryetarja e Komunës e aprovoj këtë kërkesë për pjesëmarrjen e disa bizneseve të sektorëve të ndryshme të Komunës së Gjakovës në “Panairin e Turizmit 2016”, në Prishtinë, duke e mbështetur me mjete financiare të subvencioneve komunale në vlerë prej 1,351.10€ dhe një herësh e autorizon Drejtorin për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të këtyre mjeteve financiare.

Në bazë të theksimeve të përshkruara më lartë, u vendos si në dispozitiv .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

4. Vendimi iu dërgohet:

- CC: - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomi
- N.P.Sh. “CEO” sh.p.k Prishtinë rr. “Emrush Miftari, Prishtinë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila



**FATURE
INVOICE**



Komuna e Gjakovës
Gjakovë, Kosovë, 50000

N.P.Sh. "CEO" Sh.p.k
Str.Emrush Miftari 12,1000 , Prishtina
Tel: +381(0)38 220003
FAX:+381(0)38 225092
info@ceokos.com
www.ceokos.com
Biz:registration nr:70263803
Fiscal nr: 600264709

Invoice/Fatura Nr: 1043
Date/Data: 04.19.2016

Për pjesëmarrje në PanairinTravel Fair 21- 22 Prill 2016

Pershkrimi/Description	Njesia/Unit	Sasia/Quantity	Cmimi,njesi/Unit Price	Gesamtpreis/Total
Regjistrimi				70.00 €
Hapësira Ekspozuese				660.00 €
Ndërtimi I Stendës				300.00 €
Katalogu I Panairit				70.00 €
Info Desk				35.00 €
Kabllo Vazhduese e rrymës				10.00 €
Total without V.A.T/Vlera pa tvsh:				1,145.00 €
18% VAT/TVSH. :				206.10 €
Total amount/Vlera Totale				1,351.10 €


Amount payable 4 days after receipt of invoice /Te paguhet brenda 4 diteve pas marrjes se Fatures.

Bank details/Llogaria Bankare:

Procreditbank Kosovo
IBAN: XK051110228169000183
Account nr for local transfers only/Nr.i Llogarise:
1110228169000183
BIC:MBKOKXPR
Receiver/Pranuesi: CEO shpk

Correspondent bank/Intermediary:
COMMERZBANK Frankfurt am Main
SWIFT code: COBADEFF

Invoiced prepared/Faturroi:



Accept/Pranoj:



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Bordi i Drejtorëve
01 Nr. 06-20027-7/1
Dt: 15.04.2016

Bordi i Drejtorëve i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt: 15.04.2016, pas diskutimeve lidhur me piken e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës për pjesëmarrje e Komunës së Gjakovës dhe bizneseve të Komunës në “Panairin e turizmit 2016” në Prishtinë, e miratoi këtë:


P ë r f u n d i m

7.1 Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 1,351.10€ për pjesëmarrje në “Panairin e Turizmit 2016” në Prishtinë që do të organizohet nga organizata CEO (Congress and Event Organization).

Shuma e mjeteve financiare për pjesëmarrje në “Panairin e Turizmit 2016” në vlerë prej 1,351.10€ do të sigurohen nga linja për mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.

CC: - Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

Kryetarja e Komunës


Znj. Mimoza Kusari - Lila



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO PRIVREDE I FINANSIJA – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE

Kërkesë Zotimi për Blerje
(Kërkesë iniciale kur përdoret Moduli i Blerjes)

Departamenti: KK - ZHVILLIMI EKONOMIK - GJAKOVE	Nr. Referencës së Departamentit 3016_____	
Nr.kërkesës për blerje 2016-	Nr.i zotimit 2016-	Nr.i fatures pranimit mallarave
Nr.urdhëreses për blerje	Nr.i Obligimit	Nr.i Kuponit shpenzimit PO

1	0
---	---

Fondi Burimor:

6	3	2
---	---	---

Kodi i Organizativ

4	8	0	1	6
---	---	---	---	---

Kodi i Programit

0	0	0	0	0
---	---	---	---	---

Kodi i Projektit

0	4	1	1
---	---	---	---

Kodi funks:

Përshkrimi i përgjithëm: SHERB.KONTRAKTUSE

Nr	Përshkrimi i shpenzimit:	Data e dorëzimit		Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
		Prej	Deri				
1	PJESMARRJA NE PANAIRIT TRAVEL Kodi Ekonomik 1 3 4 6 0	20.04.2016	30.06.2016	KEST	1	1,351.10	1,351.10 €
2	Kodi Ekonomik						
3	Kodi Ekonomik						
4	Kodi Ekonomik						
Gjithsej:							1,351.10 €

Kjo kontratë do të përdoret për pagesa të shumfishta nën një kontratë (bashkangjit detajet).

Udhëzime speciale:

Sugjerimet:

Zyrtari administrativ: GANI RAMA Nënshkrimi _____ data: _____

Me këtë vërtetohet se mjetet janë në dispozicion dhe se mund të fillojë regjistrimi në SIMFK - FreeBalance dhe procesi i prokurimit:


Zyrtari Autorizues: SILVANA DOMI Nënshkrimi _____ data: 25/04/2016

Mjetet e destinuar janë zotuar në organizatën buxhetore të FreeBalance:

Zyrtari Zotues: SHYQERIJE NUQI Nënshkrimi _____ data: _____



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova
08 - zyrtarisht



Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica
Municipality of Gjakovë

DATË/A:	14.04.2016
PËR/ZA/TO:	Bordin e Drejtorëve – Mbledhja e datës 15.04.2016
KOPJE/A/CC:	Kryetaren e Komunës zj. Mimoza Kusari Lila
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) Drejtori: znj. Silvana Domi.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kabinetit të kryetares dhe zyrës ligjore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë: 1. Pjesëmarrja e komunës së Gjakovës dhe bizneseve të komunës në “Panairin e Turizmit 2016” në Prishtinë.

Të nderuar,

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në kuadër të aktiviteteve të saja dhe mbështetjes së sektorit të turizmit të komunës së Gjakovës, planifikon të mbështesë bizneset e komunës së Gjakovës për pjesëmarrje në Panairin e Turizmit si dhe prezantimin e ofertës së komunës së Gjakovës për këtë sektor.

Panairi ndërkombëtar i turizmit organizohet nga organizata CEO (Congress and Event Organization) me seli në Prishtinë dhe atë në datat 21-22.04.2016. DZHE pas konsultave me bizneset e interesuara dhe me stafin e saj rreth aktiviteteve të saja në sektorin e turizmit ka kontaktuar organizatoret dhe është dakorduar me kushtet dhe ofertën e tyre. Me këtë rast ka nënshkruar marrëveshjen paraprake me të cilën ka siguruar shtandet e nevojshme dhe logjistiken përcjellëse për prezantim.

DZHE kërkon miratimin e Bordit të Drejtorëve për pjesëmarrje të komunës së Gjakovës në këtë aktivitet si dhe miratimin e shpenzimeve që dalin nga marrëveshja e kontraktuar dhe që kapin vlerën prej: **1,351.10 Euro.**

DZHE propozon që këto mjete të merren nga linja e “mallrave dhe shërbimeve” e DZHE-së.

Me respekt,